



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



RREGULLORE

PËR TAKSA, TARIFA, NGARKESA ADMINISTRATIVE DHE SHËRBIMEVE TË TJERA KOMUNALE

2014

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 12.1, 12.2 (c), 40.2(a) dhe (g), Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-049 neni 8, Statutin e Komunës së Mamushws nenet 18 dhe 45 , Rregulloren e Punës së Kuvendit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Mamushws në mbledhjen e mbajtur me datë _____. 2014 miratoi:

R R E G U L L O R E N
PËR PAGESËN E TAKSAVE, TARIFAVE DHE NGARKESAVE ADMINISTRATIVE
DHE SHËRBIMEVE TË TJERA KOMUNALE

Kapitulli I : Të përgjithshme

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohen lartësia e tarifave dhe ngarkesave administrative dhe shërbimeve të tjera komunale të cilat u ofrohen qytetarëve dhe bizneseve në territorin e Komunës.

Neni 2

Sipas kësaj rregullore, Komuna mund të vjelë të gjitha të hyrat në bazë të tarifave dhe ngarkesave.

Neni 3

Kjo rregullore përcakton në veçanti për secilën tarifë dhe ngarkesë detyrat dhe obligimet e çdo drejtorie dhe shërbimet së bashku me lartësinë dhe mënyrën e pagesës.

DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME

Kapitulli II : Tarifat dhe Ngarkesat

Pjesa 1 : Çertifikatat

Neni 4

4.1	Dokumentet zyrtare	Lartësia e taksës €
4.1.1	Ekstrakt i lindjes	1.00
4.1.2	Certifikatat e lindjes	1.00
4.1.3	Certifikatat e vdekjes	1.00
4.1.4	Certifikatat e kurorëzimit	1.00
4.1.5	Certifikatat e Vendbanimit	1.00

4.2	Dokumentet e konfirmuara	Lartësia e taksës €
4.2.1	Certifikata e statusit martesor	1.00
4.2.2	Regjistrimi i mëvonshëm në librat e gjendjes civile	10.00
4.2.3	Vërtetimi mbi lajmërimin – ç' lajmërimin e vendbanimit	2.00
4.2.4	Certifikata se personi është në jetë	2.00
4.2.5	Certifikata e bashkësisë familjare	2.00
4.2.6	Vërtetimet tjera për botën e jashtme	5.00
4.2.7	Certifikata e nënshtetësisë	2.00
4.2.8	Përmirësimi i emrit dhe mbiemrit (me gabimin e zyrtarit pala lirohet nga pagesa)	5.00
4.2.9	Dërgimi i dokumenteve brenda Kosovës përmes faxit zyrtar (një faqe)	1.00
4.2.10	Dërgimi i dokumenteve jashtë Kosovës përmes faxit zyrtar (një faqe)	2.00
4.2.11	Ndërrimi i emrit apo i mbiemrit	20.00
4.2.12	Për konfirmim të statusit martesor	5.00

4.2.13	Certifikata e gjendjes familjare	1.00
4.2.14	Përpilimi dhe lëshimi i Aktvdekjes	5.00
4.2.15	Lëshimi i certifikatës mbi identitetin	3.00
4.2.16	Lëshimi i certifikatës mbi vendqëndrimin	2.00
4.2.17	Vërtetim që personi i caktuar nuk është banor i Mamushes	2.00
4.2.18	Lëshimi i vërtetimit mbi shpenzimet e varrimit	2.00
4.2.19	Gjetja - sigurimi i dokumenteve në arkivin e Komunës	2.00
4.2.20	Kërkesë për fitimin e shtetësisë	5.00
4.2.21	Kërkesë për lirim nga shtetësia	10.00
4.2.22	Ri-regjistrimet në LAL, LAV dhe LAM sipas vendimit të organit kompetent dhe sipas dokumentacionit të posaçëm (edhe nga bota e jashtme)	Pa pagesë
4.2.23	Kërkesa, parashtrësia dhe ankesa	Pa pagesë

4.3	Vërtetim i dokumenteve zyrtare	Lartësia e taksës €
4.3.1	Vërtetimi zyrtar, përshkrimeve dhe fotokopje (1 faqe me tekst)	1.00 €
4.3.2	Kopjet e vërtetuara të autorizimeve, lejeve dhe licencave	2.00 €

Neni 5

Zyrtarët nga Drejtoria për Administratë të Përgjithshme janë përgjegjës për këto shërbime dhe mbetet për obligim që zyrtarët e autorizuar (Qendra për Shërbim Qytetarëve) të bëjnë vjeljen, lëshimin e dëftesave dhe dorëzimin e pagesave në fund të orarit të punës Zyrtarit të të Hyrave vetanake të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, kurse zyrtari i të hyrave pas barazimit me zyrtarin e zyrës së pritjes bënë dorëzimin në xhirollogarinë e komunës.

Neni 6

Me prezantimin e dokumentit të dëshmisë, anëtarët e ngushtë të familjeve të dëshmorëve, invalidët e luftës dhe anëtarët e ngushtë të familjeve të tyre, veteranët e luftës dhe anëtarët e ngushtë të familjeve të tyre, anëtarët e ngushtë të familjeve të viktimave civile të luftës, personat me aftësi të kufizuara dhe personat që realizojnë ndihma sociale në Qendrën për Punë Sociale, këto kategori lirohen nga pagesa e të gjitha shërbimeve nga neni 4.1 deri neni 7.1 (përjashtimisht 4.3.1.dhe 4.3.2) të kësaj rregullore.

Neni 7

7.1	Shërbimi i arkivit historik	Lartësia e taksës €
7.1.1	Për gjetjen e lëndës në arkiv pas vitit 2005	5.00 €
7.1.2	Kopje të projekteve individuale dhe tjera, për çdo faqe te formatit A4	0.20 €
7.1.3	Kopje te projektit për çdo faqe te formatit A3	0.50 €

DREJTORIA PËR ARSIM KULTURË RINI DHE SPORT

Pjesa 2

7.2. Udhëzimi administrativ 03/2013 lëshimi i dokumenteve dublikate nga institucionet edukative-arsimore dhe universitare.

7.2.1	Dëftesa duplikat	1 €
7.2.2	Diploma duplikat	1 €

7.3. Udhëzimi administrativ 11/2011 për participimin e vijuesve të arsimit dhe aftësimin për të rritur.

7.3.1	Për regjistrimin e vitit (për një klase 100 €)	100 €
7.3.2	Për praktik profesionale	50 €
7.3.3	Provim diferencial	10 €
7.3.4	Për provimet përfundimtare te klasës, certifikatën	30 €
7.3.5	Për diplome të përfundimit të shkollimit	20 €

DREJTORIA PËR PLANIFIKIM, URBANIZËM DHE GJEODEZI - KADASTËR

Neni 8

Pjesa 3

8.1. Çmimorja e shërbimeve komunale kadastrale

Udhëzim administrativ Nr.05/2012-MMPH për tarifën e shërbimeve dhe produkteve kadastrale të ofruara nga zyrtarët kadastrale komunale dhe kompanitë gjeodetike të licencuara

Nr.i Tarifës		Vlera €	
Ndërrimi i kulturave të parcelave			
8.2.	Ndërrimi i kulturës të një parcele pa matje	10.00	
8.3.	Për çdo parcele tjetër që kufizohet me të	5.00	
8.4.	Ndërrimi i kulturës në një parcele me matje	75.00	
8.5.	Për çdo parcele tjetër që kufizohet me të	25.00	
Ndarja e Parcelave			
8.6.	Ndarja e një parcele sipas gjendjes faktike në teren deri në 0.50 ha	75.00	
8.7.	Për çdo ndarje në pjesë tjetër	25.00	
8.8.	Ndarja e një parcele sipas gjendjes faktike në teren deri në 0.50-1.0 ha	100.00	
8.9.	Ndarja e një parcele sipas gjendjes faktike në teren deri në 1.0-5.0 ha	150.00	
8.10.	Ndarja e parcelës në pjesë të përcaktuara më parë	80.00	
8.11.	Ndarja në më tepër se dy pjesë të përcaktuara më parë për çdo pjesë	40.00	
8.12.	Ndarja e komplekseve në sip. 5-10ha në dy pjesë	200.00	
8.13.	Për çdo ndarje në pjesë tjetër	100.00	
8.14.	Ndarja e komplekseve me sip. mbi 10 ha, në dy pjesë	500.00	
8.15.	Për çdo ndarje në pjesë tjetër	200.00	
Bashkimi i parcelave			
8.16.	Bashkimi i parcelave pa matje	20.00	
8.21.	Për çdo parcele tjetër në kufi	10.00	
Matja e ndërtesave			
8.23.	Matja për një ndërtesë individuale për 1m ² të bazës gjeodezike	0.50	
8.19.	Çdo ndërtesë tjetër në të njëjtën parcele 1m ² të bazës gjeodezike	0.25	
8.20.	Ndërtesë banimi kolektivë për 1m ²	0.50	
8.21.	Çdo ndërtesë tjetër në të njëjtën parcelë	0.50	
8.23.	Ndërtesa afariste për 1m ²	0.70	
8.23.	Çdo ndërtesë tjetër në të njëjtën parcelë për 1m ²	0.70	
8.23.	Ndërtesa banesore- afariste për 1m ²	0.7	
8.25.	Çdo ndërtesë tjetër në të njëjtën parcelë për 1m ²	0.50	
8.26.	Ndërtesë e administratës qeveritare dhe publike për 1m ²	0.50	
8.27.	Për çdo ndërtesë tjetër në të njëjtën parcelë për 1m ²	0.50	
8.28.	Objektet për sport dhe rekreacion (stadium, halla sportive etj.)	0.50	
8.29.	Objektet kulturore dhe fetare për 1m ²	0.30	
8.30.	Për çdo ndërtesë tjetër në të njëjtën parcelë për 1m ²	0.50	

Matjet e pjesëve të ndërtesave		
8.31.	Hapësirat banesore dhe përpilimi i skicave për 1m ²	0.80
8.32.	Kati me skicat e njësive të veçanta për m ²	0.70
8.33.	Hapësirat afariste dhe përpilimi i skicës për 1m ²	1.00
8.34.	Ndarja e hapësirave banesore dhe përpilimi i skicës për 1m ²	0.75
8.35.	Ndarja e hapësirës afariste dhe përpilimi i skicës për 1m ²	0.75
Matjet e përqojave		
8.36.	Përvoja nëntokësore për m gjatësi	0.50
8.37.	Përvoja mbitokësore për m gjatësi	0.25
8.38.	Objektet nëntokësore	100.00
8.39.	Për çdo objekt tjetër	50.00
8.40.	Tunelet për metër gjatësi	5.00
Përcaktimi i kufijve të parcelave		
8.41.	Për një parcelë me sipërfaqe deri 0.50 ha	80.00
8.42.	Për sipërfaqe prej 0.50-1.00 ha	100.00
8.43.	Për çdo hektar tjetër mbi 1ha	60.00
8.44.	Për parcelat urbane sipas pl urbanistik pas marrjes së pëlqimit nga drejtoria	120.00
Rregullimi i kufijve të parcelave		
8.45.	Për një parcele me sip. deri në 0.50 ha	40.00
8.46.	Për sip. prej 0.50 ha deri 1.00 ha	50.00
8.47.	Për çdo hektar tjetër	30.00
Dhënia e dëshmimeve nga baza e të dhënave kadastrale tekstuale apo grafike sipas kërkesave të palëve nga ZKK		
8.48.	Dhënia e vërtetimeve të ndryshme	3.00
8.49.	Çertifikata mbi pronën	4.00
8.50.	Kopja e planit A ₄ për një parcelë	5.00
8.51.	Për çdo parcelë tjetër	2.00
8.52.	Kopja e hartave kad.A ₀ ,leter e thjesht ,horizontal. (Përpjesa: 1:500, 1:1000, 1: 2500 e 1:5000)	20.00
8.53.	Historiati për një parcelë	30.00
Punët e zyrës sipas kërkesave të palëve		
8.54.	Identifikimi I njësive kadastrale në teren-për një njësi	20.00
8.55.	Për çdo njësi tjetër në kufi	5.00
8.56.	Kontrollimi dhe regjistrimi në regjistër i të dhënave nga terreni për një njësi kadastrale	20.00
Punët e veçanta gjeodezike		
8.57.	Bartja në teren e të dhënave nga planet urbanistike për objektet individuale për 1m ²	0.50
8.58.	Bartja në teren e të dhënave nga planet urbanistike për objekte banimi kolektiv apo afarist për 1m ²	0.50
Punët tjera sipas kërkesave të palëve (identifikime të njësive kad.e tjera)		
Baza Gjeodezike		
Pikat Trigonometrike:		
8.59.	Koordinatat Y, X ,me përshkrim	5.00
Pikat Lidhëse:		
8.60.	Koordinatat Y, X , me përshkrim	4.00
Pikat Poligonale:		
8.61.	Koordinatat Y, X, Z me përshkrim	3.00
Pikat Reper:		
8.62.	Koordinatat Y, X, Z me përshkrim	5.00
Pikat në linjë		
8.63.	Koordinatat Y, X, Z	2.00

Pikat e detajit		
8.64.	Koordinatat Y, X	1.00
8.65	Vendosja e pikave trigonometrike	50.00
Regjistrimi pronësisë, posedimit, në bazë të transaksioneve (shitblerjes		
UDHEZIMI ADMINISTRATIV NR. AKK 08/2014		
8.66	Për vlerën e transaksionit deri në 10,000 €paguhet taksa prej:	20.00
8.67	Për vlerën e transaksionit prej 10,000 €deri në 30,000 €paguhet taksa prej:	30.00
8.68	Për vlerën e transaksionit prej 30,000 €deri në 50,000 €paguhet taksa prej:	35.00
8.69	Për vlerën e transaksionit prej 50,000 €deri në 100,000 €paguhet taksa prej:	50.00
8.70	Mbi vlerën 100,000 €për çdo 50,000€tejkallim paguhet vlera prej 30 €por shuma e taksës së përgjithshme nuk mund të kalojë vlerën e 300 €	
8.71	Po që se vlera e kontratës–transaksionit është e pavlerësushme paguhet taksa:	70.00
Regjistrimi i pronësisë, posedimit, në bazë të dokumentit mbi dhuratën		
8.72	Nëse në dokumentin (kontratën) mbi dhurimin e pronës së paluajtshme e që dhuratëmarrësi është anëtar i familjes apo pasardhës i dhuratëdhënësit e që është caktuar vlera e pronës, në këto raste do të paguhet 30% taksa-tarifa për çdo pronar-posedues që fiton të drejtën mbi pronën e paluajtshme sipas dhurimit, sipas tarifës të përcaktuar në pikat (; 8.65; 8.66,8.67,8.68,8.69 ,8.70).	
8.73	Nëse në dokumentin (kontratën) mbi dhurimin e pronës së paluajtshme e që dhuratëmarrësi nuk është anëtar i familjes apo pasardhës i dhuratëdhënësit e që është e caktuar vlera e pronës në këto raste do të paguhet taksa-tarifa për çdo pronar-posedues që fiton të drejtën mbi pronën e paluajtshme sipas dhurimit, sipas tarifës të përcaktuar në pikat (; 8.65; 8.66,8.67,8.68,8.69 ,8.70).	
8.74	Nëse në dokumentin (kontratën) mbi dhurimin e pronës së paluajtshme e që dhuratëmarrës janë anëtarët e familjes së ngushtë të dhuratëdhënësit ,ndërsa nuk është e caktuar vlera e pronës në kontratë, në këto raste do të paguhet taksa-tarifa në shumë prej 50 €për çdo pronar-posedues që fiton të drejtën mbi pronën e paluajtshme sipas dhurimit.	
8.75	Nëse në dokumentin (kontratën) mbi dhurimin e pronës së paluajtshme e që dhuratëmarrës nuk janë anëtarët e familjes së ngushtë të dhuratëdhënësit , ndërsa nuk është e caktuar vlera e pronës në kontratë, në këto raste do të paguhet taksa-tarifa në shumë prej 80€për çdo pronar-posedues që fiton të drejtën mbi pronën e paluajtshme sipas dhurimit.	
Regjistrimi i pronësisë, posedimit, në bazë të dokumentit të organeve administrative dhe gjyqësore mbi njohjen e të drejtës së pronësisë-posedimit.		
8.76	Regjistrimi i të drejtave mbi pronën e paluajtshme e cila fitohet në bazë të Vendimit të organit administrative apo gjyqësor, bëhet duke paguar taksën – tarifën në shumë prej:	50.00
Regjistrimi i pronësisë, posedimit, në bazë të pjesëtimit (ndarjes) të pronës në bashkëpronësi		
8.77	Regjistrimi i pronësisë, i posedimit në bazë të pjesëtimit (ndarjes) të pronës në bashkëpronësi bëhet duke paguar tarifën në shumën prej 20 €për një akt juridik me të cilin është vendosur bashkëpronësia.	
8.78	Regjistrimi i pronësisë, i posedimit në bazë të pjesëtimit (ndarjes) fizike të pronës nga bashkëpronësia,pagesa bëhet duke paguar nga 20 €nga secili bashkëpronarë që bëhet pronar individual nga pjesëtimi fizik i pronës	
8.79	Për regjistrimin e pronës së përbashkët bëhet duke paguar tarifën në shumë prej 20 €për një akt juridik me të cilin është vendosur prona e përbashkët.	
8.80	Regjistrimi i pronësisë së përbashkët të ndërtesave në bashkëpronësi bëhet duke paguar tarifën në shumë prej 20 €	

8.81	Regjistrimi i pronësisë së përbashkët të ndërtesave në bashkëpronësi me të gjithë pronarët e pjesëve të veçanta bëhet duke paguar tarifën në shumë prej 100 €.	
Regjistrimi i pronësisë, posedimit, në bazë të Trashëgimisë dhe të shkëputjes së bashkësisë familjare.		
8.82	Regjistrimi i pronësisë, posedimit në bazë të Trashëgimisë bëhet duke paguar tarifën në shumën prej 10 €për çdo trashëgimtar.	
8.83	Regjistrimi i pronësisë, posedimit në bazë të shkëputjes së bashkësisë familjare bëhet duke paguar tarifën në shumën prej 10 €për çdo anëtarë të familjes që bëhet pronar, posedues.	
Regjistrimi i pronësisë, posedimit, në bazë të ndërrimit të pronës së paluajtshme.		
8.84	Regjistrimi i pronësisë, posedimit, në bazë të ndërrimit të pronës së paluajtshme, bëhet duke paguar tarifën në shumën prej 30 €për secilin pronar – posedues.	
REGJISTRIMI I HIPOTEKAVE		
Regjistrimi i Hipotekave do të bëhet sipas vlerave të kërkesave (kredive) të përcaktuar me dokumentin e hipotekës dhe atë:		
8.85	Kërkesa (kredia) në vlerën prej 10,000 €paguhet taksa – tarifa në shumën prej:	10.00
8.86	Kërkesa (kredia) në vlerën prej 10,000 €- 30,000€paguhet taksa – tarifa prej:	20.00
8.87	Kërkesa (kredia) në vlerën prej 30,000 €- 50,000€paguhet taksa – tarifa prej:	30.00
8.88	Kërkesa (kredia) në vlerën prej 50,000 €- 100,000€paguhet taksa – tarifa prej:	80.00
8.89	Mbi vlerën 100,000 € për çdo 100,000 €tejkalim paguhen edhe nga 30 €por shuma e tarifës – taksës nuk mund ta kaloj vlerën financiare mbi 400 €	
NDRYSHIMI DHE FSHIRJA E HIPOTEKAVE		
8.90	Ndryshimi i hipotekës së regjistruar bëhet duke paguar tarifën në shumë prej 30 €	30.00
8.91	Për fshirjen e Hipotekës nga Regjistri i të Drejtave mbi pronën e Paluajtshme duhet të paguhet taksa – tarifa në shumën prej:	10,00
REGJISTRIMI I SERVITUTEVE		
8.92	Regjistrimi i të drejtës së Servitutit në Regjistrin e të drejtave mbi pronën e paluajtshme bëhet duke paguar tarifën në shumë prej:	50.00
8.93	Fshirja e Servitutit nga regjistri bëhet duke paguar tarifën në shumën prej	20.00
REGJISTRIMI I TË DREJTËS SË SHFRYTËZIMIT – QIRAMBAJTJA		
8.94	E drejta e shfrytëzimit – Qirambajtje me kohëzgjatje prej 3 deri në 10 vite mund të regjistrohet duke paguar tarifën në shumën prej:	50.00
8.95	E drejta e shfrytëzimit – Qirambajtje me kohëzgjatje prej 10 deri në 25 vite mund të regjistrohet duke paguar tarifën në shumën prej:	150.00
8.96	E drejta e shfrytëzimit – Qirambajtje me kohëzgjatje deri në 99 vite mund të regjistrohet duke paguar tarifën në shumën prej:	500.00
8.97	Fshirja e të drejtës së shfrytëzimit – Qirambajtja bëhet duke paguar 20% e shumës që është paguar për regjistrimin e të drejtës së shfrytëzimit.	
8.98	Me rastin e bartjes së të drejtës së shfrytëzimit – Qirambajtjes ose nënqiran tek personat e tretë paguhet tarifa e cila është e përcaktuar nën nenin 2. e 3. të këtij Udhëzimi administrativ.	
REGJISTRIMI I BARRAVE DHE NGARKESAVE TË NDRYSHME		
8.99	Për regjistrimin e barrës në tatimin e pronës së paluajtshme bëhet duke paguar tarifën në shumë prej 20 €.	
8.100	Për regjistrimin e barrës tatimore bëhet duke paguar tarifën në shumë prej 30 €.	
8.101	Për regjistrimin e masës së sigurisë (masa e përkohshme) që procedura gjyqësore ose ndonjë procedurë tjetër është udhëhequr me kërkesë private të palës duhet të paguhet tarifa prej 50 €	

8.102	Për regjistrimin e masës së sigurisë (masa e përkohshme) që procedura gjyqësore ose ndonjë procedurë tjetër është udhëhequr sipas detyrës zyrtare nga një organ kompetent për zbatimin e ligjit (Prokuroria, policia e tjera.) nuk do paguaj asnjë tarifë.
8.103	KORIGJIMI I TË DHËNAVE NË REGJISTER Nëse të dhënat që duhet të korrigjohen janë futur në regjistër si pas dokumentacionit të dorëzuar nga palët korrigjimi bëhet duke paguar pala 20 €
8.104	Nëse të dhënat që duhet të korrigjohen janë futur në regjistër me veprimin e ZKK-ës ose nga AKK-ja, korrigjimi bëhet pa pagesë.

Neni 9

- 9.1. Për punët në teren prej 15 nëntorit deri më 15 mars çmimet janë më të larta për 25%
- 9.2. Për punët dhe shërbimet që do të kryhen në tokat pyjore çmimet do të jenë më të larta për 30%.
- 9.3. Pala duhet të sigurojë transportin dhe punëtorët ndihmës për kryerjen e punëve në teren.
- 9.4. Me prezantimin e dokumenteve të dëshmisë, anëtarët e ngushtë të familjeve të dëshmorëve, invalidët e luftës dhe anëtarët e ngushtë të familjeve të tyre, veteranët e luftës dhe anëtarët e ngushtë të familjeve të tyre, anëtarët e ngushtë të familjeve të viktimave civile të luftës, personat me aftësi të kufizuar dhe personat që realizojnë ndihma sociale me këtë rregullore do të lirohen nga pagesa e tarifave nga neni 8 pika 8.49 dhe 8.50. të kësaj rregullore.

Pjesa 4 : Tarifat dhe ngarkesat për ndërtim dhe urbanizëm

Neni 10

Të bëhet përshkrimi i vijës kufitare të zonave të ndërtimit

10.1	Lejet e ndërtimit dhe rregullimi i tokës ndërtimore	
10.1.1	Objektet individuale te banimit, Objektet bujqësore, Objektet prodhuese – industriale (për m ²):	3.00
10.1.2	Për legalizimin e objekteve individuale të banimit	3.00
10.1.3	Objektet kolektive te banimit, objektet e biznesit	3.00
10.1.4	Për legalizimin e objekteve (lokaleve) afariste	3.00
10.1.5	Pompat e benzinës (për m ³ të kapacitetit të rezervarëve të derivateve)	7.50
10.1.6	Fushat e përkohshme sportive	300.00
10.1.7	Vendosja e antenave – transmetuesve si telefonisë, celulare, fikse, internetit .	300.00
10.1.8	Për centralet elektrike me fuqi prodhuese të rrymës deri në 20 MWh	1000.00/€MWh
10.1.9	Për pishinat verore	2.00/m ²
10.1.10	Për bazene për kultivim të llojeve të ndryshme të peshqve	2.00/m ² .
10.1.11	Për shndërrimi e lokaleve banesore në lokale afariste (ndërrim i destinacionit ne sektorin privat apo shtetërore për m ²)	3.00
10.1.12	Mbi ndërtimi dhe shndërrimi i hapësirave të përbashkëta në banim	3.00
10.1.13	Tarifa rregullative për rritjen e densitetit të infrastrukturës (për m ² /kokë banori)*	96.72

Tarifës sipas pikës 10.1.3 vlen edhe për objekte përcjellëse

*10.1.13. Kjo tarifë sipas ligjit të ndërtimit bëhet me marrëveshje të posaçme me pronarin.

10.2	Tarifat dhe ngarkesat për lejet mbi shfrytëzimin e objekteve caktohen në lartësi prej 20% të vlerës se tarifave dhe ngarkesave për leje ndërtimi
10.3	Qiraja në pronësi të lokaleve pronë e K.K. Mamushes, (për m²/ muaj):

	Sipërfaqja deri ne 50 m ²	2.50
	Sipërfaqja deri ne 100 m ²	2.00
	Sipërfaqja me mbi 100 m ²	1.50
10.3.1	Sipërfaqet ndihmëse të lokaleve (kuzhinat, depot etj)	0.50
10.4	Qiraja për shfrytëzimin e tokës, pronë e komunës për biznes	
10.4.1	Objektet e përkohshme (për m ² / muaj):	
	Zona I	0.60
	Zona II	0.50
	Zona III	0.40
	Zona IV	0.30
Qiraja sipas pikës 10.4.1. vlen për katin përdhes. Për katet tjera vlere e qirasë llogaritet sa 50% e qirasë për katin përdhes.		
Vërejtje: Përgjatë rrugëve magjistrale dhe rajonale qiraja për shfrytëzimin e tokës pronë e Komunës për qëllime biznesi është sikurse ne zonën I – e parë.		
10.4.2	Qiraja për shfrytëzim të tokës ndërtimore për banim dhe destinim tjetër (Për m ² / në vit)	
	Për banim	0.50
	Për garazha	2.00
	Për destinim tjetër – Parkim	2.00
10.4.3	Qiraja për dhënien në shfrytëzim të objektit për banim-prone Komunale m ² /muaj	0.30€
10.5	Për lëshimin e vërtetimit në caktimin e vlerës së objektit:	
	Për objektet deri më 100 m ²	10.00
	Për objektet prej 101 – 500m ²	20.00
	Për objektet prej 501 – 1000m ²	30.00
	Për objektet prej 1001 – 2000m ²	40.00
	Për objektet më të mëdha, për çdo 1000 m ² , tarifa rritet për	10.00
* Vlerësimi bëhet nga Komisioni për vlerësime të pasurisë i formuar nga Kryetari;		
10.6	Për daljen në teren sipas kërkesave	10.00
Vërejtje: Këtu përjashtohen rastet e daljes në teren gjatë shqyrtimit të kërkesave për leje ndërtimi dhe për leje shfrytëzimi.		
10.7	Pagesa për leje rrënimi	10.00
10.8	Pagesa për leje pune	10.00
10.9	Për dhënien e Pëlqimeve të ndryshme	10.00
10.10	Për ndarje fizike të ngastrës kadastrave	10.00
10.11	Lëshimi i vërtetimeve te ndryshme	1.00
10.12	Pagesa për aplikim për leje përdorimi	5.00
10.13	Pagesa për dalje në vendshiqim për konstatim profesional	20.00
10.14	Lëshim i vërtetimit mbi shkallën e dëmtimit	1.00

Neni 11

Masat ndëshkuese apo dënimet të cilat duhet t'i zbatoj zyrtari i deleguar, përkatësisht Inspektori i ndërtimtarisë janë të përcaktuara me Ligjin mbi Ndërtimin , të miratuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Neni 12

12. Taksat dhe tarifat për dhënien e lejes mjedisore komunale

Taksat dhe tarifat për dhënien e lejes mjedisore komunale janë të kategorizuar në gjashtë grupe, së bashku me shumën që duhet paguar (qimorën), subjektet për t'u pajisur me Leje Mjedisore Komunale:

12.1 Grupi i parë – 400 €

1. Fabrika për përpunim druri, mobilieri, tapiceri deri 1000m³/vit
2. Fabrika për ambalazhimin e ujit natyral, mineral; me kapacitet deri në 0.5 m³ në ditë
3. Fabrika për prodhimin e lëngjeve frutash, pije freskuese; pijesh alkoolike me kapacitet deri në .5 m³ në ditë
4. Fabrika për përpunim të qumështit dhe produkteve të tij, deri 1000 kg/ditë
5. Fabrika për përpunim të vajrave bimore, lulediellit etj, me kapacitet 500l/ ditë.
6. Prodhimi i gëlqeres (shuarja) deri 100 ton/vit
7. Prodhimi i betonit dhe elementeve parafabrikate, pllakave etj. Me kapacitet deri në 50 m³ beton/ditë
8. Magazinimi i lubrifikantëve të ambalazhuar në vende prodhim
9. Grumbullimi i mbeturinave të konstruktimit demolim për qëllime të riciklimit përfshirë seleksionimin, copëtimin mekanik dhe deponimin e tyre si dhe caktimin e vendit për deponim
10. Prodhimi i këpucëve dhe aksesorëve të tjerë të ngjashëm, pa procese kimike (qepje, ngjitje montim)
11. Prodhimi i kartonit dhe ambalazheve të tjerë, me kapacitet deri 500 kg/ditë
12. Rritja artificiale e peshkut në hurdhë, me sipërfaqe deri në 300 m²

12.2 Grupi dytë -280 €

1. Pikëshitjet e gazit (GLN) deri 4.9 m³
2. Furrat për prodhim të bukës dhe produkteve të miellit
3. Thertore me kapacitetet deri 3 gjedhë /ditë
4. Fabrika për përpunim të pemëve dhe perimeve deri në 1000 kg/ditë
5. Punishtet e vogla për përpunim të mermerit, me sipërfaqe totale-objekti deri në 200 m³
6. Ndërtimi i objekteve të banimit dhe shërbimeve, me sipërfaqe ndërtimi më të madhe se 1000m²
7. Magazinat frigorifer, për produktet ushqimore të ambalazuara me kapacitet total magazinues deri në 50 ton

12.3

Grupi i tretë- 240 €

1. Sharrimi i lëndës drunore
2. Pikat e magazinimit dhe tregtimit të materialeve të ndërtimit
3. Impiantet për rritjen intensive të shpezëve, bagëtive të imta dhe të mëdha që kanë më pak se
 - 1). 2000 shpend
 - 2). 30 gjedhë
 - 3). 200 bagëti të imëta

12.4 Grupi i katërt-160€

1. Autoservisat
2. Veprimtaria e prodhimit të kompostit, me sasi totale përpunimi deri në 100m³ ose 40 ton gjatë vitit
3. Vendet ku janë të magazinuar, më pak se 10 ton mbeturinë inerte
4. Vendet ku janë të magazinuar, më pak se 2 ton mbeturinë e pa rrezikshme
5. Impiantet për riciklimin dhe prodhimin e masave plastike me kapacitet deri 1000t/vit

12.5 Grupi i pestë- 80€

1. Autolarjet
2. Magazinimi i plehrave kimike dhe pesticideve me kapacitet magazinues deri ne 10 ton
3. Qebaptoret dhe gjellëtoret
4. Vendet e tregtimit të kafshëve në ambient të hapur (tregjet tradicionale) ose të mbyllura

5. Tregjet urbane industriale dhe të produkteve bimore dhe shtazore

12.6 Grupi i gjashtë- të liruara

Projektet publike:

1. Rrjeti i kanalizimeve të ujërave të zeza dhe rehabilitimet e tyre në gjatësi deri 5 km
2. Rrjeti i kanalizimeve të ujërave të zeza dhe rehabilitim i ujësjellësve ekzistues në gjatësi deri 5 km
3. Rikonstruksion i rrugëve urbane dhe rurale ekzistuese dhe ndërtimi i akseve të reja rrugore (me gjatësi deri në 2 km)
4. Plantacionet e drurëve frutore
5. Projektet e përmirësimit të pyjeve, pyllëzime, sistemime etj;

DREJTORIA PËR BUXHET, FINANCA DHE ZHVILLIM EKONOMIK

Pjesa 5

Neni 13

13. Tarifat dhe ngarkesat në zejtari Veprimtaritë punuese

12.1	Ortarët	Liruar
12.2	Rrobaqepësit	Liruar
12.3	Këpucëtarët	Liruar
12.4	Argjendarët	80.00€
12.5	Bukëpjekësit	80.00€
12.6	Frizerët për meshkuj (rrojtoret)	48.00€
12.7	Floktarët për femra (frizeret)	48.00€
12.8	Automekanikët	80.00€
12.9	Autoelektracist	80.00€
12.10	Autollaker	80.00€
12.11	Gomisteritë	32.00€
12.12	Auto larjet	40.00€
12.13	Serviset e pajimeve të amvisërisë	32.00 €
12.14	Xhamaprerësit	40.00 €
12.15	Fotografistët	23.00 €
12.16	Përpunues të llamarinës (Teneqepunuesit)	40.00 €
12.17	Punëtoritë të cilat merren me prodhimin e dymit dhe dritareve	80.00 €
12.18	Shitoret tregtare të aparateve elektrike, teknikës së bardhë dhe aparateve të TV	80.00 €
12.19	Shitoret tregtare të kompjuterëve dhe pajisjeve të tjera informative	80.00 €
12.20	Shitoret tregtare të plastikës	48.00 €
12.21	Shitoret tregtare me produkte sanitare dhe elektrike	48.00 €
12.22	Ndërmarrjet që merren me shitjen e duhanit	100.00 €

Neni 14

Pjesa 6 : Tarifat e Taksës në Pronë

Tarifat e taksës në pronë zbatohen sipas Rregulloreve vjetore komunale mbi vendosjen e tatimit në pronë në territorin e komunës së Mamushes, të cilat shqyrtohen dhe miratohen për çdo vit në Kuvendin e Komunës.

Pjesa 7 : NGARKESAT VJETORE NGA USHTRIMI I VEPRIMTARIVE AFARISTE

Neni 15

15.1. Shitoret dhe objektet tjera Tregtare:

Shitoret për shitjen e prodhimeve bujqësore	32.00 €
Kioskat	16.00 €
Barnatoret farmaceutike	100.00 €
Drogeritë – për shitjen e materialeve sanitare, higjienës, kozmetikë etj.	80.00 €
Shitoret ushqimore, marketet dhe supermarketet për m ² / vit	0.80 €
Libraritë	50.00 €
Butiqet	48.00 €
Shitoret e autopjesëve dhe autogomave	80.00 €
Shpërndarësit e rrjetit të internetit	200.00 €
Shpërndarësit e rrjetit kabllorik	300.00 €
Telefonitë fikse private (me kabinë)	16.00 €
Riparimi gjeneratorëve dhe motorsharrave	80.00 €
Podrumet e pijeve alkoolike dhe joalkoolike	80.00 €
Pompat e benzinës	700.00 €
Deponitë e naftës dhe derivateve tjera	2000.00€
15.2 Ndërmarrjet	
Ndërmarrjet me efekt të rëndë	40,000.00 €
Ndërmarrjet me efekt të mesëm	10,000.00 €
Ndërmarrjet me efekt të ulët	2,000.00 €
Industritë Ushqimore	1,200.00 €
Ndërmarrjet ndërtimore që merren me ndërtime të larta dhe të ulëta	280.00 €
Ndërmarrjet ndërtimore që merren me suvatim dhe me mveshje të dysHEMEVE dhe mureve	250.00 €
Ndërmarrjet industriale të vogla	240.00 €
Ndërmarrjet pyjore	160.00 €
Ndërmarrjet tregtare me qarkullim transit	80.00 €
Nxjerrja e gurit (gurëthyesit)	1,500.00
Depot e materialit ndërtimor	280.00 €
Depot e rërës dhe zhavorrit	160.00 €
Ndërmarrja publike	800.00 €
Laboratori për cilësinë e derivateve	2,000.00 €

15.3. Aktivitet shërbyese

15.3.1. Shërbimet Financiare:

Bankat	800.00 €
Njësit e bankës (filialet)	240.00 €
Bankomatet	240.00 €
Agjensionet financiar që merren me transfere parash dhe pagesa	300.00 €
Kompanitë e sigurimit	200.00 €
Agjencitë Doganore	160.00 €

15.3.2. Shërbimet e Komunikacionit dhe Transportit:

Shërbimet telekomunikuese	900.00 €
Agjencitë turistike	80.00 €
Kompanitë transportuese	80.00 €
Për një kamion shtesë	20.00 €
Kompanitë e Pastrimit	160.00 €
Auto - shkollat	80.00 €

15.3.3. Shërbimet Hoteliere:

Kafiteritë	80.00 €
Hotelet	240.00 €
Motelet	160.00 €
Restorantet	240.00 €
Internet Kafet	64.00 €
Mishtoret	120.00 €
Gjellëtoret	80.00 €
Pizeritë	80.00 €
Qebaporet	40.00 €
Byrektoret	40.00 €
Hamburgerët	23.00 €
Çajtoret	23.00 €

15.3.4. Aktivitet tjera shërbyese:

Video klubet dhe shumëzuesit e kasetave	16.00 €
Lojërat e ndryshme	23.00 €

15.4. Veprimtaritë e Pavarura Profesionale:

Ordinancat mjekësore	200.00 €
Avokatët	80.00 €
Stomatologët	80.00 €
Mjekët	80.00 €
Veterinarët	100.00€
Veprimtari tjera të pavarura:	
• Financa dhe kontabilitet.....	120.00 €
• Arkitektët	120.00 €
• Gjeometrat	160.00 €
• Shërbime Juridike	40.00 €
• Shkollat	200.00 €
private, institucionet parashkollore (qerdhet)	

15.5. Llotaritë dhe Lojërat:

Llotaria - njësitë e kompanive	200.00 €
Organizuesit e lojërave shpërblyese	200.00 €
Bastoret Sportive	1,500.00 €
Automate në klube të veqanta	1,500.00 €

15.6. Veprimtaritë tjera :

Fushat sportive	80.00 €
Fitnes – bodibullding	23.00 €
Veprimtaritë tjera	16.00 €
Pëlqimet per pranimin teknik te lokalit	10,00 €

Neni 16

Pjesa 8 : Ngarkesat vjetore komunale për automjetet e regjistruara në territorin e Komunës së Mamushes

16.1 Ngarkesa vjetore :

16.1.1	Automjetet me peshë deri më 3,5 ton	10.00 €
16.1.2	Automjetet me peshë mbi 3,5 ton	20.00 €

Neni 17

Automjetet e intervencës, automjetet e Kryqit të Kuq, automjetet speciale të mbrojtjes shëndetësore, automjetet e zjarrfikëseve, të ndërmarrjeve publike (automjetet për transportimin e të vdekurve, mjetet motorike për pastrimin e kanalizimeve dhe lumenjve, automjetet për bartjen e mbeturinave, mjetet motorike për transportimin e fekaleve, mjetet motorike për bartjen e kafshëve të ngordhura etj.) dhe automjetet e shfrytëzuesve të administratës komunale, nuk i nënshtrohen pagesës së këtyre tarifave dhe ngarkesave.

Neni 18

Automjetet bujqësore nuk i nënshtrohen pagesës së tarifave dhe ngarkesave Komunale për automjet.

Neni 19

Invalidët dhe invalidët e luftës me invaliditet trupor më tepër se 50% nuk i nënshtrohen pagesës së këtyre tarifave dhe ngarkesave.

Neni 20

Të gjitha bizneset që regjistrohen për herë të parë lirohen nga taksat komunale për (2) dy vite, ndërsa gjinia femërore e cila hapin biznes të ri lirohen nga taksa 4 vite. Çdo biznes i ri që ka të punësuar deri dhjetë persona lirohet nga taksat për (3) tri vite, kurse çdo biznes i ri që ka të punësuar mbi dhjetë persona lirohet nga taksat komunale për (5) pesë vite.

Subjektet afariste të cilat veprimtarinë e tyre e zhvillojnë më tepër se një lokal jashtë selisë paguajnë 60% të taksës së përcaktuar të secilit lokal veç e veç.

DREJTORIA PËR BUXHET, FINANCA DHE ZHVILLIM EKONOMIK do t'i lëshoj aktvendimet mbi ngarkesat vjetore komunale për ushtrimin e veprimtarive të bizneseve të gjitha bizneseve Komunale, kurse obliguesit janë të detyruar që krahas pagesës së taksës për ngarkesën vjetore sipas nenit 18 të kësaj rregullore dhe aktvendimit të posaçëm, të dëshmojnë pagesën e këtij obligimi duke e prezantuar para shërbimeve tona të inspektionit gjatë inspektionit.

DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Pjesa 9

Neni 21

21 Tarifat dhe gjobat për Shërbime Publike

		Tash
Nr. i tarifës, ngarkesave	Shërbimet/aktivitetet, tarifat/ngarkesat dhe gjobat	Vlera në € për m ²
Ndërrhyrja pa leje në infrastrukturën publike		
21.1	Personi fizik	250.00
21.2	Personi juridik	1,000.00
Dëmtimi i rrugëve dhe trotuareve gjatë kryerjes së punëve të ndryshme ndërtimore		
21.3	Për 1 m ² dëmtim të asfaltit	150.00
21.4	Për 1 m ² dëmtim të gurëve kubza ose pllaka	100.00
21.5	Për dëmtim të trotuarit të pa asfaltuar (hapja e kanaleve në trotuar)	50.00

21.6	Dëmtimi i skajoreve m ²	40.00
21.7	Dëmtimi i rigollave m ²	40.00
21.8	Personat juridik apo fizik, të cilët gjatë punëve ndërtimore dëmtojnë rrugët, hapësirat-objektet tjera publike, janë të obliguar t'i evitojnë dëmet e shkaktuara në afat prej 5 ditësh, në të kundërtën gjobiten me shumën e vlerësuar për dëmin e shkaktuar sipas tarifave 1.3, 1.4, 1.5, 1.6, 1.7	
Hedhja e mbeturinave në hapësirat publike		
21.9	Personi fizik	70.00
21.10	Personi juridik	300.00
21.11	Hedhja e mbeturinave nga kalimtarët jashtë vendeve të caktuara.	10.00
Hedhja e mbeturinave dhe materialeve jashtë deponisë së qytetit		
21.12	Personi fizik	100.00
21.13	Personi juridik	300.00
Për keqpërdorimin e ujit të pijshëm:		
21.14	Personi fizik	100.00
21.15	Personi juridik	400.00
Larja e veturave dhe automjeteve të tjera në trotuar dhe rrugë		
21.16	Personi fizik	60.00
21.17	Personi juridik	150.00
Derdhja e ujërave në hapësirën publike dhe ujërave të zeza		
21.18	Personi fizik	80.00
21.19	Personi juridik	300.00
Shfrytëzimi pa leje i trotuareve dhe hapësirave tjera publike:		
	Vendosja e objekteve të vogla të përkohshme- sezonale, lëvizëse (aparate për akulllore, tavolina, gjenerator, objekte reklamuese etj.)	
21.20	Personi fizik	50.00
21.21	Personi juridik	100.00
21.22	Objektet më të mëdha lëvizëse (gjeneratorë, kioskë, bankomatë, automjeteve për reklamim, Luna Park, etj.)	200.00
Gërvishtja, prerja, lakimi, ndotja ose dëmtimi në çfarëdo forme i objekteve me interes të përgjithshëm siç janë: kabinat telefonike, ndriçimi publik, shenjat e komunikacionit dhe mbrojtjen e rrethojave të drunjëve dekorativetj.		
21.23	Personi fizik	150.00
21.24	Personi juridik	300.00
21.25	Dëmtimi i bimëve dekorative nëpër parqe (këputja e luleve, gjetheve etj.)	40.00
21.26	Dëmtimi i ulëseve dhe pjesëve përcjellëse të parqeve (ndotja, thyerja dhe dëmtimet tjera)	50.00
21.27	Dëmtimi i rrethojave për mbrojtjen e gjelbërimit për m	50.00
Kalimi (shkelja) me këmbë ose me automjet nëpër sipërfaqet e gjelbëruara të parqeve dhe hapësirave të tjera të ndaluara publike		
21.28	Personi fizik	25.00
21.29	Personi juridik	200.00
Shërbimet		
21.30	Pranimi i kërkesave	5.00
Tërheqja dhe vendqëndrimi i automjeteve të konfiskuara		
21.31	Bartja e automjetit me kaçubet	30.00

21.32	Bartja jashtë zonës së qytetit për 1/km. (gjatësia llogaritet për ardhje dhe kthim)	0.50
Nëse pronari e largon automjetin para arritjes së operatorit për tërheqje, për operatorin paguan – shpenzimet e transportit		
21.33	Zona urbane	10.00
21.34	Jashtë zonës urbane tarifës 3.33 i shtohet edhe tarifa 3.32	
Nëse automjeti nuk tërhiqet (merret) brenda 48 orëve, pas kësaj kohe, për çdo 24 orë do të paguhet për vendqëndrim, në autoparkun e KK-së		
21.35	Veturat 24 orë	5.00
21.36	Kombit dhe kamionët e lehtë deri 3.5 T, për 24 orë	8.00
21.37	Kamionët nga 3.5 T deri 7.5 T	10.00
21.38	Kamionët mbi 7.5 T për orar 24 orë	15.00
Lejet për ndërhyrje në infrastrukture dhe hapësirë tjetër publike		
21.39	Leja për prerjen e asfaltit në rrugë dhe trotuare 1m ²	
21.40	Për persona fizik	20.00
21.41	Persona juridik	50.00
Ngarkesat për shfrytëzimin e sipërfaqeve Publike, detyrimi bazë është për shfrytëzimin e m ² , sipas zonave të qytetit. Vendosja e tezgave lëvizëse dhe kiosqeve dhe objekteve tjera të vogla, të përkohshme – sezonale, lëvizëse në të cilat kryhet veprimtaria (tregti, hotelieri) si dhe pajisjeve të caktuara teknike (gjeneratorë e të ngjashme) - tarifa mujore.		
21.42	Zona I për m ²	10.00
21.43	Zona II për m ²	8.00
21.44	Zona III për m ²	6.00
Vendosja e mjeteve për akullore dhe mjete tjera të ngjashme - tarifa mujore.		
21.45	Zona I për aparat	15.00
21.46	Zona II për aparat	10.00
21.47	Zona III	7.00
Vendosja e stendave të hapura dhe lëvizëse për shitjen e librave jo shkollor caktohet tarifa - tarifa mujore.		
21.48	Zona I	10.00
21.49	Zona II	7.00
21.50	Zona III	4.00
Shfrytëzimi i hapësirës publike para objektit në të cilën kryhen shërbime hoteliere – tarifa mujore.		
21.51	Zona I për m ²	5.00
21.52	Zona II për m ²	4.00
21.53	Zona III për m ²	3.00
Ekspozimi i pllakateve (panove) reklamuese - Tarifa vjetore për m ²		
21.54	Zona urbane	30.00
21.55	Zona jashtë urbane	20.00
21.56	Pllakatet (panot) reklamuese me ndriçim paguhen me tarifë të shtuar	30%
21.57	Pllakatet (panot) reklamuese të cilat shfrytëzojnë ndriçimin publik tarifave duhet shtuar edhe shpenzimet e energjisë elektrike për objektin reklamues .	
21.58	Vendosja e reklamave elektronike - ekraneve tarifë vjetore për m ²	150.00
21.59	Reklamimi i pijeve alkoolike dhe duhanit është i ndaluar	
21.60	Për shfrytëzime tjera të hapësirës publike- ekspozimi (reklamimi) për 1 m ² – tarifa mujore.	10.00
21.61	Nëse shfrytëzimi reklamues bëhet më pak së 30 ditë	100%

	shtohet vlera për	
21.62	Nëse pllakati është shumë krahësh, paguhet për çdo krah të dukshëm.	
21.63	Nëse pllakati është i vendosur në pronë private (të vetën), por për objektiva reklamimin, pala paguan sipas pikave 1.52, 1.53, 1.54 dhe 1.55 me zbritje.	50%
Ngarkesat për organizimin e lodrave argëtuese, të fatit dhe lodrave argëtuese automatike të ndryshme, si dhe rekuizitave tjera sportive.		
21.64	Vendosja e aparateve për lojëra fati, lojëra argëtuese etj. Tarifa mujore për çdo aparat sipas llojit	10.00
21.65	Shfrytëzimi i hapësirës publike për vendosjen e objekteve argëtuese (parqeve argëtuese – Luna Park). Tarifa mujore për m ²	1.50
Shërbime tjera		
21.66	Leja për vendosjen e materialit ndërtimor në hapësirat publike për 24 orë	25.00
21.67	Leje për bllokim të rrugës – shiritit rrugor – trotuarit për 24 orë	25.00
21.68	Dëmtimi i drunjëve dekorativ nëpër hapësira publike të asfaltuara të qytetit	200
21.69	Vërtetimi i rendit të udhëtimit - Operatori transportues paguan taksën për një vit për 1km.	0.50
21.70	Pëlqimi për plotësimin e kushteve teknike për vendparkimin e automjeteve transportuese për mallra dhe udhëtar	30.00
Parkingjet e rezervuara – tarifë mujore		
21.71	Në parkingjet e Komunës	40.00
	Në parkingjet publike në shirita të ndara të rrugëve – trotuareve	
21.72	Personi fizik	15.00
21.73	Personi juridik	25.00
Parkingu kohor për 1 orë		
21.74	Në parkingjet e KK-së	0.50
21.75	Në parkingjet publike në shirita të ndara të rrugëve – zona I	0.30
21.76	Në parkingjet publike në shirita të ndara të rrugëve – zona II	0.20
21.77	Pëlqim për zhvarrosjen (eksëhumacionin e kufomave), e mbetjeve të kufomës.	lirohet
21.78	Vendosja e foltoreve telefonike(tarife mujore)	10.00
Leje për vendosjen e transmetuesve (antenave), me frekuenca të ndryshme dhe objekteve tjera të ngjashme, për nevoja të telefonisë mobile, fikse, televizionit, internetit e tjera të ngjashme, paguhet tarifa vjetore (nga vlera e llogaritur e objektit):		
21.79	Zona Urbane	800.00
21.80	Zona Rurale	500.00
21.81	Pëlqim – për plotësimin e kushteve teknike për kyçje-qasje në infrastrukturën rrugore dhe pëlqime tjera	10.00
Taksa për Automjetet Motorike		
21.82	Për automjetet deri 125 cm ³	5.00
21.83	Për automjetet nga 125 cm ³ deri në 3500 cm ³	10,00
21.84	Për automjetet dhe taksi – automjete mbi 3500 cm ³	20,00
Shfrytëzimi i mineraleve (lënda minerale) Materiale të palidhura dhe inert		
21.85	Për rërë dhe zhavorr – aluvione për m ³ duhet paguar	1.25

21.86	Për rërë dhe zhavorr në lum për m ³ duhet paguar	1.25
Kyçja ilegale ne sistemin e ujësjellësit		
21.87	Personi fizik	500.00
21.88	Personi juridik	3,000.00
Tarifa për dhënien e pëlqimit të kyçjes në ujësjellës		
21.89	Për ekonomi familjare	50.00
21.90	Për subjekte afariste	100.00
21.91	Vendosja e kablove nëntokësore dhe përvojave në metra gjatësi	
21.92	Zona urbane	0.30
21.93	Zona rurale	0.10
21.94	Tarifat për shfrytëzimin e infrastrukturës komunale për subjektet të cilat eksploatojnë dhe përpunojnë resurse natyrore – në vit	400.00 e re

Neni 22

Pjesa 10: Tarifat dhe ngarkesat në xehetari dhe bujqësi

23.1		
23.1.1	Gëlqere shtresore (artizanal)	0.50
23.1.2	Gëlqere shtresore (Industrial)	2.50
23.1.3	Mergelë	0.80
23.1.4	Uji Mineral	2.00
23.1.5	Tarifat për dhënien e pëlqimit për eksploatimin e gurit , përpunimin e gurit , rërës, mergelës dhe burimeve të tjera minerale	200.00
23.1.6	Tarifat për dhënien e pëlqimit për hulumtimin e gurit , rërës, mergelës dhe burimeve të tjera minerale	50.00
23.1.7	Tarifa për dhënien e pëlqimit për shfrytëzim të ujit për ekonomi familjare	50.00
23.1.8	Tarifa për dhënien e pëlqimit për shfrytëzim të ujit për subjekte afariste	100.00
23.1.9	Vlerësimi i kushteve dhe dhënia e pëlqimit për bizneset që merren me shitje të farërave, plehrave artificiale, pesticidëve etj.	10.00
23.1.10	Kompensimi për shëndërim të tokës bujqësore dhe pyjore në tokë ndërtimore - për m ²	
a)	klasa e 1-4 kompensimi do të jetë	1.00
b)	klasa e 5-6 kompensimi do të jetë	0.70
c)	klasa e 7-8 kompensimi do të jetë	0.50
23.2	Kërkesa për vlerësimin e gjendjes në teren	
23.2.1	Për persona fizik	20.00
23.2.2	Për persona juridik	50.00

DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

Neni 23

Pjesa; 11 : Shërbimet e shëndetësisë të nivelit parësor dhe inspektimeve (Udhëzimi Administrativ Nr.06/2006 – Bashkë pagesat nga shfrytëzuesit e shërbimeve shëndetësore)

23.1. Pëlqimet sanitare nga Inspekcioni Sanitar për Lejet e ndërtimit të objekteve sipas llojit dhe zonave (për m²) :

- 23.1.1 Objektet e prodhimit dhe të qarkullimit ushqimor;
- 23.1.2. Pompat të karburanteve;

- 23.1.3. Objektet shëndetësore;
- 23.1.4. Objektet për furnizim me ujë të pijshëm;
- 23.1.5. Objektet kulturore, edukativo-arsimore, sociale, të kulturës fizike
- 23.1.6. Objektet për eliminimin dhe deponimin e mbeturinave;
- 23.1.7. Varrezat dhe krematoriumet;
- 23.1.8. Objektet tjera për të cilat mund të rrezikojnë shëndetin e popullatës;

Zona I	0,20
Zona II	0,15
Zona III	0,10
Zona IV	0,05

Vërejtje: Sipas Ligjit mbi inspektim , nuk lejohet që Investitorit t'i jepet leja për ndërtim ose për përdorimin e objektit të rindërtuar apo të rikonstruktuar.

Inspekcioni Sanitar

23.2 Në bazë të Udhëzimit Administrativ (MSH) Nr.11/2006 për zbatimin e Ligjit për Inspektoratin Sanitar të Kosovës nr.2003/22

Tarifat dhe ngarkesa tjera	
Mos pajisja me librezë sanitare të personave që kanë të bëjnë me ushqimin dhe pijet si shërbime ofrimi, përpunimi apo servili.	25.00 €
Për mos mbajtje të higjienës personale (duar të papastra, thonj të pa prerë dhe higjienë tjetër personale).	25.00 €
Mosndërmarrja e veprimit të D.D.D-së për të gjitha subjektet afariste tregtare, subjektet që merren shërbime të ofrimit të ushqimit të përpunuar dhe të shitjes një herë në gjashtë muaj.	50.00 €
Mosndërmarrja e veprimit profilaktik të D.D.D-së për të gjitha objektet publike dhe private edukativo-arsimore dhe shëndetësore njëherë në vit.	70.00 €
Për shkelje të normave sanitare (falsifikimet në teknologjinë e ushqimit , mirëmbajtja e ujësjellësit, klorozimi).	500.00 €
Për mangësi Higjienike të subjekteve hoteliere.	200.00 €
Për ekspozim te artikujve ushqimor dhe pijeve që janë në kundërshtim me kushtet e ruajtjes dhe shitjes (jo adekuate)në treg apo në kundërshtim me kushtet e dhëna nga deklaracioni i prodhuesit.	
Për persona juridik	100.00 €
Për persona fizik	50.00 €
Konfiskimi i të gjitha mallrave (artikujve) me afat të skaduar ushqimore, pijeve dhe produkteve tjera si : kozmetik etj, të vëna në qarkullim ose me kërkesë të palës.	100.00 €
Mospasja me uniformë pune për veprimtarinë e përcaktuar me Ligj.	25.00 €
Lëshimi i vërtetimit për izolim , konfiskim dhe shkatërrim malli ushqimor dhe produkte tjera kozmetike dhe higjienike në varësi nga sasia e mallit dhe vlerës së regjistruar duke pasur parasysh sasinë e mallit prej 5 kg deri 100 kg.	50.00 €
Lëshimi i vërtetimit për izolim, konfiskim dhe shkatërrim malli ushqimorë dhe produkte tjera kozmetike në varësi nga sasia e mallit dhe vlerës së regjistruar duke pasur parasysh sasinë e mallit mbi 100 kg.	100.00 €
Marrja e mostrës nga ana e inspektorit sanitar për verifikim, analizim të artikullit apo pijeve ushqimore në subjektin afarist tregtar ushqimor, hotelier, shërbyes etj, marrja e kësaj mostre në atë subjekt do të bien barrë shpenzimi i një mostre në vlerë.	30.00 €
Në rast të rezultateve pozitive nga institucionet shëndetësore mbi infeksionin apo helmimin e klientit nga subjekti afarist tregtar apo shërbyes me artikuj ushqimor, pije etj. Masa e gjobës do të jetë:	500.00 €

Gjjobiten personat fizik që pinë duhan në hapsirë të mbyllur, në kundërshtim të Ligjit për Kontrollin e Duhanit Nr.04/L-156/2013 .	50.00 €
Ankesa e qytetarit drejtuar inspekcioni sanitar për produktin ushqimor jo higjienik-shëndetësor, të skaduar, në rast të verifikimit nga ana e inspektorit sanitar dhe vërtetimit në subjektin afaristë të atij artikulli ushqimor gjoba do të jetë:	50.00 €

23.3. Tarifat dhe taksat e pagesave për shërbimet shëndetësore të nivelit parësor

Nr.	Lloji i shërbimit	Vlera në €
1	Ekzekutimi mjekësor në punkt. QMF ose në QKMF , pa analiza laboratorike ose pa procedura plotësuese diagnostike me aparaturë	1.00
2	Ekzaminimi në shtëpi , përpos në raste emergjente	6.00
3	Medikamenti nga lista esenciale , ofruar në barnatoren publike	0.30
4	Ultrazëri standard	2.00
5	Radiografia	2.00
6	EKG	0.50
7	Analizat laboratorike-vetëm hemogrami dhe urina	1.00
8	Analiza laboratorike –(komplet)	3.00
9	Caktimi i sheqerit në gjak me glikometër sipas kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore	1.00
10	Audiograma	1.00
11	Shpëlarja e veshit	1.00
12	Dhënia e injeksionit intramuskular në shtëpi,përpos rasteve emergjente	1.00
13	Dhënia e injeksionit intravenoz në shtëpi ,përpos rasteve emergjente	1.00
14	Përpunimi i plagëve me qepje dhe pastrimi deri në shërim të plagës(vetëm në vizitën e parë)	3.00
15	Trajtimi ditor me infuzione në institucionin shëndetësorë	1.00
16	Certifikata mjekësore e lëshuar sipas kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore	23.00
17	Dhënia e raportit mjekësor, vërtetimi apo dokumentit tjetër në bazë të kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore.	5.00
18	Ofrimi i shërbimeve shëndetësore gjatë aktiviteteve sportive, etj. Për një orë.	25.00

23.4 Taksat për shërbimet stomatologjike në nivelin parësor.

Nr.	Emërtimi	Vlera në €
1	Vizita e parë stomatologjike	1.00
2	Rtg i dhëmbit	2.00
3	Mbushje e përhershme me amalgam	4.00
4	Mbushje e përhershme me kompozitë	5.00
5	Shërimi biologjik i dhëmbit me mbushje të përhershme (amalgam apo kompozitë)	5.00
6	Amputimi vital i pulpës me mbushje të përhershme (amalgam apo kompozitë)	5.00
7	Extirpimi vital i pulpës me mbushje të përhershme (amalgam apo kompozitë)	5.00
8	Terapia e kanalit të infektuar me mbushje të përhershme (amalgam apo kompozitë)	6.00
9	Rindërtimi konservativ i dhëmbit me mbushje të përhershme të dhëmbit	6.00

10	Revizioni i mbushjes së kanalit të rrënjës	1.00
11	Fluorizimi i dhëmbëve sipas seancës	1.00
12	Vulosja e fisurave	1.00
13	Nxjerrja e dhëmbit	1.50
14	Incizioni intra dhe ekstra oral	1.50
15	Heqja e kurorës me anë të prerjes	1.00
16	Riparimi i protezës(ngjitja)	1.50
17	Rindërtimi konservativ i dhëmbit me mbushje të përhershme	8.00
18	Mënjanimi i depozitimeve të buta	1.00
19	Nxjerrja e dhëmbit në mënyrë operative	4.00
20	Mënjanimi i depozitimeve të forta(heqja e gurzëve të dhëmbëve me ultratingull)	4.00
21	Kiretazha e xhepave parodontale (një dhëmb)	1.00
22	Ndërhyrjet operative parodontale	12.00
23	Nxjerrja e dhëmbit në mënyrë operative	4.00

23.5. Tarifat dhe ngarkesat e QPS

Nr	Tarifat dhe ngarkesat e QPS	Euro
1	Vërtetim për humbjen e shtetësisë së Kosovës	2
2	Vërtetim për fitimin e shtetësisë së Kosovës	2
3	Vërtetim që nuk i është hequr zotësia e punës dhe veprimit	2
4	Vërtetim që nuk është shfrytëzues i ndihmave sociale	2
5	Pëlqimi për martesë para moshës madhore	5
6	Kërkesë për regjistrim të mëvonshëm të fëmijës	5
7	Pëlqim për përfaqësim në gjykata për fëmijë lidhur me trashëgimi, kontratave të ndryshme etj.	3
8	Pëlqim për udhëtim jashtë vendit për familje	3
9	Pëlqim për bartjen e pasurisë	2
10	Pëlqim për dokumentet e udhëtimit	2
11	Konstatimet të ndryshme zyrtare	3

23.5 Nga bashkëpagesat për shërbimet shëndetësore të ofruara sipas paragrafit 23.3, 23.4, 23.5 të kësaj rregulloreje, lirohen të gjitha kategoritë e popullatës të parapara me nenin 61 të ligjit për shëndetësi me numër Nr .04/L-125.

23.6 Çmimet për shërbimet shëndetësore të ofruara sipas paragrafit 23.3, 23.4 për shtetasit e huaj dhe bartës të sigurimeve të huaja do të jenë për pesë (5) herë më të larta se sa për banorët e Kosovës.

Neni 24

Me prezantimin e dokumentit të dëshmisë, anëtarët e ngushtë të familjeve të dëshmorëve, invalidët e luftës, veteranet, personat me aftësi të kufizuara, anëtarët e ngushtë të viktimave të luftës dhe personat që realizojnë ndihma sociale në Qendrën për Punë Sociale, këto kategori lirohen nga pagesa e të gjitha shërbimeve Shëndetësore.

Neni 25

Ngarkesat vjetore sipas aktvendimeve do të paguhet në konton bankare të Komunës, në çdo bankë komerciale sipas faturimit të bërë nga zyrtari kompetent i komunës në afatin prej 30 ditësh nga dita e marrjes së aktvendimit, ndërsa në rastet e mospagesës do të lëshohet urdhëresë e posaçme për pagesë dhe pas skadimit të afatit prej tetë (08) ditësh nga marrja e kësaj urdhërese, do t'i bëhet aktvendimi mbi ndalimin e ushtrimit të veprimtarisë dhe inicimi i procedurës ligjore – fletëparaqitja në Gjykatën Kompetente.

Neni 26

Në rast se ndonjë dispozitë e kësaj rregullore është në kundërshtim me ndonjë dispozitë të Ligjit apo të udhëzimeve administrative të nivelit qendror që i rregullojnë këto lëmi, atëherë respektohen dispozitat e Ligjit, përkatësisht Udhëzimeve të nivelit Qendror.

Neni 27

Kjo rregullore hynë në fuqi ditën e miratimit nga kuvendi i komunës dhe do të ekzekutohet pas konfirmimit të ligjërisë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.

Mamushe

Data: _____. 2014

Kryesuesi i Kuvendit

Fuat Taç
